

**❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE**

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektesh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

**❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES**

Specialist i Infrastruktures dhe Sherbimeve IT

**❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT**

Qëllimi i pozicionit është administrimi, mirembajtja dhe mirefunksionimi i Infrastruktures, Rrjetit, si edhe ruajtja maksimale e sigurisë dhe integritetit të dhenave të kompanisë.

**❖ DETYRAT KRYESORE**

- Kryen ditë pas ditë shërbimet e PC ,Workstation dhe printerave në administratën dhe kantieret e kompanisë.
- Kryen ditë pas ditë suportin helpdesk ndaj punonjësve të kompanisë për problematikat Software/Hardware
- Kryen ditë pas ditë Shërbimin e Infrastruktures;
- Ndjek procedurat baze të percaktuara për sistemet e IT dhe realizon dhe kontrollon backupet kryesore të sistemeve në përgjegjësi të tij.
- Kryen ditë pas ditë Shërbimin dhe Suportin për Infrastrukturen IT (servera+aplikime)
- Kryen ditë pas ditë kontrollin për rrjetin Data të kompanisë dhe kryen konfigurimet e reja.
- Raporton tek drejtori i drejtorisë për çdo problem lidhur me SLA, dhe problematikat me kontraktoret të cilët nuk i përgjigjen sinjalizimeve të tona;
- Shqyrton kërkesat, merr aprovim dhe raporton tek drejtori i drejtorisë për të gjitha blerjet e hardware që duhet të kryhen për administratën e shoqërisë;
- Katalogon inventarin e pajisjeve IT për kompaninë, merr në dorezim produktet nga furnitori, si dhe i dorëzon ato tek përdoruesi me anë të një procesverballi;
- Shqyrton, merr aprovim dhe raporton tek drejtori i drejtorisë për të gjitha pagesat e kryera për shërbimet jashtë kontraktore për sistemet që menaxhon;
- Kryen Shërbimin ndaj Përdoruesve sipas një grafiku pune të udhëzuar nga përgjegjësi i sektorit;
- Ndjek projektet e reja të sektorit IT nën udhëheqjen e përgjegjësit të njesisë .

**❖ KRITERET KRYESORE**

Edukimi: Të ketë përfunduar fakultetin e Informatikës/Shkencë Kompjuterike/Inxhinieri elektronike.

Gjuhë të huaja: Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze

Eksperiencën e punës: Mbi 2 vjet eksperiencë pune.

Te gjithë të interesuarit, janë të lutur që të dergojnë CV nepermjet adreses së e-mailit [careers@gener2.al](mailto:careers@gener2.al) ose të plotesojnë formularin e aplikimit në faqen zyrtare [www.gener2.al](http://www.gener2.al) në seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit është **data 10 Maj 2022, ora 17:00**.

\* Vetëm kandidatet e perzgjedhur do të kontaktohen.

\* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrotjen e të dhënave personale”.